REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 38/17
Datë/Datum 24.03.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW

PSH. Nr. 38/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, në përbërje prej: z. Nuhi Paçarizi - Kryetar, z. Tefik Sylejmani – Referues, z. Ekrem Salihu – Anëtar, Blerim Dina – Anëtar, dhe Goran Milenkovic – Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga OE konzercium **"Fans a.s & NPSH Elektronic Business-PRO"**, me seli në Çeki, lidhur me aktivitetin prokurimit: **"Modernizimi i fushave në Kullën ftohëse Blloku.A4"**, me nr. prokurimi: **KEKO-16/114/511**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Korporata Energjetike e Kosovës (KEK)**, më: 21.03.2017, mori këtë :

V E N D I M

I. **HUDHET,** poshtë si e palejuar ankesa OE "Fans a.s & NPSH Elektronic Business-PRO" me seli në Çeki, me nr.prot. 38/17, kundër vendimit të AK-së - Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), për aktivitetin e prokurimit: "Modernizimi i fushave në Kullën ftohëse Blloku.A4", me nr. prokurimi: KEKO-16/114/511, pasi i njëjti nuk ka arritur të dëshmoj interes juridik - material konform nenit 111 par. 1 pika 1.5 dhe 1.8 të LPP-së, lidhur me nenin 4.1.26 të LPP-së, për shkak se i njëjti ka ofruar ofertë të papërgjegjshëm teknikisht, sipas kritereve të FDT-së.

II. **VËRTETOHET**, vendimi i AK-së, Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), Njoftimi për dhënien e kontratës i datës 16.01.2017, i publikuar në web-site e KRPP-së, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Modernizimi i fushave në Kullën ftohëse Blloku.A4", me nr. prokurimi: KEKO-16/114/511. Autorizohet Autoriteti kontraktues që të vazhdoj me tutje me këtë aktivitet te prokurimit.

III. Meqenëse ankesa e operatorit ekonomik ankues "Fans a.s & NPSH Elektronic Business-PRO" - Çeki, hudhet poshtë si e pa lejuar, konform nenit 118 të LPP-së, i kthehet sigurimi i ankesës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik "Fans a.s & NPSH Elektronic Business-PRO" - Çeki, si palë e pakënaqur ka deponuar ankesë në OSHP më datë 08.02.2017, me nr. të protokollit, 38/17, kundër njoftimit për dhënie të kontratës të datës 16.01.2017 i publikuar në ëeb-site KRPP-së, duke pretenduar se Autoriteti kontraktues "KEK", ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të LPP-së, siç janë:

Neni 1 i LPP-së,

Neni 7 i LPP-së,

Neni 59 - i LPP-së

Neni 5 i RRUPP,

Neni 39.4 i RRUPP,

Pika 21.2 e dosjes së tenderit,

Nenin 28 si dhe nenin 31 të Rregullores dhe Udhëzimit për prokurim public.

Neni 11 i RRUPP,

Organi Shqyrtues i Prokurimit pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113.1 të LPP-së, ka autorizuar ekspertin shqyrtues dhe teknik, për të shqyrtuar procedurën e zhvilluar lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, si dhe vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues-teknik në raportin e datës: 13.03.2017 ka konstatuar se **në lidhje me**

pretendimin ankimor sa i përket validitetit të ofertave, vlerëson se Autoriteti kontraktues ka bërë vazhdimin e validitetit të ofertave me vones jo konform nenit 31.4 të Udhëzësuesit Operativ për prokurim publik, për në rastin konkret vazhdimi i validitetit është bërë nga OE ankues dhe OE i rekomanduar për kontrat dhe duke u bazuar në këtë dhe në vendimin e Panelit Shqyrtues të dt.25.11.2014, me nr.prot.884/14, konform pikes II, të këtij vendimi Autoritetet kontraktuese janë të obliguar që të vazhdojnë validitetin e ofertave edhe pas afatit të skadimit të validitetit të ofertave dhe për të njejtën AK-ja NUK mund të anuloj aktivitetin e prokurimit. **Eksperti shqyrtues vlerëson** në lidhje me pretendimin ankimor sa i përket qasjes në dokumentacion zyrtar, në lidhje me nenin 11 të LPP-së, vlerëson se NUK qëndron pretendimi ankimor për faktin se OE ankues në bazë të shkresave të lëndes ka pasur qasje të pakufizuar në dokumentacionin e ofertës për të cilen ka parashtruar kërkes për qasje ne dokumente zyrtare, konform nenit 11 të LPP-së.

Eksperti shqyrtues vlerëson në lidhje me pretendimin ankimor sa i përket marveshjes së konzerciumit të OE ankues, **vlerëson** se NUK qëndron pretendimi ankimor në lidhje me këtë për faktin se OE ankues në konzercium ka ofruar marveshje të konzerciumit por të njejtës i mungon përshkrimi: ***grupi duhet që së bashku me tenderin e tij të dorëzojë një deklarate të nënshkruar nga secili prej anëtarëve, që konfirmojnë pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk marrin pjesë në ndonjë grup tjetër që merr pjesë në të njëjtat procedura të prokurimit*** siç parashihet në paragrafin 2 të nenit 71 të LPP-së, citojmë: neni 71.2 i LPP-së: "*grupi duhet që së bashku me tenderin e tij të dorëzojë një deklarate të nënshkruar nga secili prej anëtarëve, që konfirmojnë pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk marrin pjesë në ndonjë grup tjetër që merr pjesë në të njëjtat procedura të prokurimit. Të gjitha autoritetet kontraktuese duhet që ta parashtrojë këtë kusht në dosjet e tyre të tenderit. Në rast së një anëtar merr pjesë në disa grupe, secili nga grupet përkatëse do të konsiderohen të papërshtatshëm.*

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor sa i përket vonesës të shkaktuar nga ana e Autoritetit kontraktues, **vlerëson** se qëndron pretendimi ankimor pasi që Autoriteti kontraktues ka bërë një vones në lidhje me vlerësimin e ofertave dhe poashtu në lidhje me zotimin e mjeteve për këtë aktivitet të prokurimit ka tejkaluar shumën e planifikuar, por duke u bazuar në shkresat e lendes Autoriteti kontraktues ka bërë zotimin shtesë te mjeteve për këtë aktivitet të prokurimit me datë 30.12.2016, duke u bazuar edhe në shkresën e zyres së prokurimit z.Isak Kerolli, i cili përshkruan në raportin e vlerësimit se pas deklarates së DP TCA të disponueshmëris së mjeteve të dt.30.12.2016, aprovon raportin e vlerësimit nga ana e komisionit profesionale.
Eksperti shqyrtues duke u bazuar në këtë vlerëson se këto vonesa NUK kanë ndikuar në vendimin

final në lidhje me rekomandimin për dhënien e kontrates. Poashtu eksperti shqyrtues vlerëson në lidhje me arsyetimin e eliminimit sa i përket pretendimit për raportin e vlerësimit dhe letrën standarde, se Autoriteti kontraktues ka paraqitur arsyet e eliminimit në letrën standarde në lidhje me OE ankues, dhe kjo është e mjaftueshme për të kuptuar të arsyet e eliminimit.

Eksperti teknik vlerëson në lidhje me pretendimin ankimor sa i përket specifikimit teknik të ofruar nga ana e OE të rekomanduar për kontrat në lidhje me ofertën e tij, vlerëson:
Në dosjen e tenderit AK-ja e ka dhënë qartë që punët duhet të jenë në përputhje të plotë me specifikat teknike të dhëna në dosjen e tenderit (Aneks 1), poashtu duhet bërë modernizimin e paisjeve në përputhje me përshkrimin që përbëhet prej Aneksit 1, (është kërkuar në bazë të materialit tenderik:elektromotor me fuqi 115KË, nr. i rrotullimeve n=1500, o/min, gjatësia e lopates L=7315mm, nr.lopatave 8, shpejtësia e lopatave n=164 o/min).

Eksperti teknik, me shikin e dosjes teknike të OE të rekomanduar për kontrat qartë shihet se dy operatoret ekonomik fituesi dhe ankuesi, elektromotor me fuqi 90KË të tipit PMH 90-180D, me fuqi P=90/11.3,KË, nr.rrotullimeve n=185/92 o/min, me peshë 2910KG, i cili siguron kapacitetin e qarkullimit të ajrit prej 400m3/sec. (mbushjet e qelizave nga PVC), si dhe eliminuesi i (pikëzimit), që ka ofruar OE i rekomanduar për kontrat janë përputhje me kërkesat për modernizimin e kullave ftohëse. Stërpikësit janë nga plastika që gjithashtu është në përputhje me dokumentacionin teknik (aneks 1).

Eksperti teknik, vlerëson pasi që në kullat e ftohëse ndryshimi i temperatures bëhet me largimin e ngrohtësis, është me rëndësi që të sigurohet shpërndarje sa më e mirë e ujit të ngroht në mënyr që të krijohet sipërfaqja sa më e gjërë prekëse, në mes të ajrit dhe ujit. Poashtu eliminuesit të pikave (pikëzimit) duhet pamundësuar daljen e pikave të ujit në atmosferë për shkak mbrojtjes së mjedisit jetësorë. Eksperti teknik, vlerëson se OE i rekomanduar për kontrat i plotëson të gjitha specifikat teknike të parashtruar ne dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontrat.

Eksperti teknik-shqyrtues, në lidhje me arsyetimin e dhënë në letër standarde nga ana e Autoritetit kontraktues sa i përket arsyeve të eliminimit të OE ankues, në lidhje me referencat, vlerëson se qëndron arsyeja e eliminimit, për faktin se OE ankues NUK ka ofruar referenca sipas kërkesës së FDT-së, konkretisht dy referenca të realizuar në 3 vitet e fundit, për faktin se:

referencat e lëshuara nga SLOVNAFT.A.S CLEN SKUPINY MOL e realizuar me 02.08.2012 e cila nuk përmbush kërkesat e dosjes së tenderit (në dosjen e tenderit është

kërkuar të jetë për tri vitet e fundit). Ju keni prezantuar referencat të lëshuara nga HEP-Proizvodnja d.o.o Pogon TE-TO Osijek –Kroaci që është realizuar në periudhën 2014 dhe 2015, por referenca nuk plotëson kriterin e dosjes së tenderit për energjinë e kërkuar të MË, OE ankues ka ofruar referenc me fuqi të përgjithshme 89/139MË, ndërsa është kërkuar me fuqi 150/250MË.

Eksperti teknik, vlerëson NUK ka çertifikat ISO të prodhuesit për produktet që dotë liferoj : electromotor, ventilator, filter të pastrimit, paket ftohëse etj.

Eksperti shqyrtues-teknik, duke u mbështetur në vlerësimet e lartë cekura, i rekomandon panelit shqyrtues që të APROVOJ si pjesërisht të BAZUAR ankesën OE "FANS&ELEKTRONIK BUSINESS-PRO", me seli në Republika Çeke, për këtë aktivitet të prokurimit dhe njëherit të MBETE në FUQI vendimi i Autoritetit kontraktues "Njoftimi për dhënien e kontratës, i datës 16.01.2017, me titull: "Modernizimi i fushave në Kullën ftohëse Blloku.A4", me nr. prokurimi: KEKO-16/114/511", i iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Korporata Energjetike e Kosovës (KEK).

OE ankues "Fans a.s & NPSH Elektronic Business-PRO" - Çeki, përmes parashtresës ka deklaruar se NUK pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

AK-ja, poashtu me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në, se PAJTOHET me raportin dhe konstatimet e ekspertit shqyrtues-teknik, për këtë aktivitet të prokurimit.

Gjatë seancës së shqyrtimit kryesor, më 20.03.2017, në të cilën ishin prezent anëtarët e Panelit shqyrtues, eksperti shqyrtues dhe teknik, përfaqësuesi i autorizuar OE ankues, përfaqësuesi i AK-së. Në seancë u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues-teknik, përgjigjja e AK-së mbi raportin e ekspertizës.

Në vazhdim fjala iu dha përfaqësuesit të OE "Fans a.s & NPSH Elektronic Business-PRO" -

Çeki " znj. Dema e cila deklaroj: "edhe pas marrjes së ekspertizës së ekspertit ne qëndrojmë pranë pretendimeve tona ankimore se në këtë aktivitet të prokurimit nga ana e AK-KEK ka shkelje të një pasnjëshme të dispozitave të LPP-së në fuqi. Ajo qka ne jemi ankuar tek AK-ja dhe në OSHP, është se kemi dhënë dëshmi shtesë që vazhdimi i validitetit është shkel në mënyrë të qëllimshme.

Në vendimin e vet AK-ja kur arsyeton vazhdimin e pranon se në një rast ka harruar të bëjë vazhdim para skadimit, mirëpo thotë se është e pa qëllimshme, dhe thotë se kemi pranuar kërkesën për vazhdim dhe nuk kemi bërë vërjejtje. Ne raport të vlerësimit shkruan se mungon vetëm deklarata, të gjitha letrat formularët për dorëzim të tre OE-ve janë nënshkruar nga komisioni është hap tenderi dhe anëtëtarët e komisionit ditën kur kanë bërë vlerësimin. Ndërsa tek ne është vetëm komisioni i hapjes mirëpo nuk është komisioni i vlerësimit, ndërsa AK-ja për këtë thotë se është e paqëllimshme, kjo dëshmon se dosja jonë nuk është vlerësuar fare, dhe është vlerësuar më vonë nga dikush tjetër dhe janë dhënë këto pika. Sa i përket certifikatave ISO, ne kemi treguar se FANS është edhe prodhuese, dhe pjesën më të madhe që furnizon janë pajisje të FANS, kompania FANS është një ndër kompanitë më të mira në Evropë për këtë lloj shërbimi.
Për referenca ajo është realisht e vitit 2014 dhe është gabim teknik i bërë nga lëshuesi i referencës, referenca dytë është modernizim , e vërtetë që nuk ka kapacitetin mirëpo është për modernizim.

Përshkrimi teknik i katalogut, ne nuk dimë qka duhet përshkruar më shumë ku për secilën pajisje që kemi ofruar është e shenuar qka po ofrohet.

Po ashtu, me rastin e përkthimit nga gjuha Ceke në Anglisht ka ndodh gabim në përkthim. Oferta jonë ka përmbajte gjitha kërkesat e kërkura me dosje, AK-ja ka mund koform nenit 59 apo 72 të bëjë kërkesë për sqarime dhe pas sqarimit tonë nëse nuk ka qenë i pranueshëm ka mund të vazhdoj, mirëpo një gjë të tillë AK-ja nuk e ka bërë".

Në vazhdim fjala iu dha përfaqësuesit të AK-së, KEK, z. Tmava, i cili deklaroj: "pretendimi kryesor i OE ankues është se oferta tyre nuk është vlerësuar me ofertat tjera, .kjo nuk qëndron, pasi në shkresat e lëndës ekspertët e OE ankues e kanë parë dhe në qasje në dokumente. Me 21.07.2016 është raporti preliminar me gjitha pikat ankimore, ku është çdo detal i precizuar, raport i shpërndarë përmes emailit, sa i përket referencave të OE fitues, ka prezantuar 40 referenca , dhe ne prej tyre kemi përzgjedh tri referenca. Aty ka një katalog të prodhuesit, ku në secilin është shënuar viti, fuqia, kur është kryer etj. Në një referenca nuk është shënuar fuqia elektranës dhe konform nenit 72 të LPP kemi bërë kërkesë për sqarime të cilën OE i rekomanduar për kontrat e ka plotësuar.

Në vitin e parë është paraparë të ndërtohet 5 kulla ftohëse prej gjithsej 10 sa janë paraparë në dosje, njësia kërkuese nuk kanë pas dijeni pasi është hera parë që bëhet një modernizim në kulla

që ne posedojmë dhe nuk kanë pasë njohuri të kostos së këtij projekti, pasi është hera parë e një aktivieti të tillë. Me datë 29.03.2016 AK-ja në kërkesat për sqarime të OE-ve në përgjigjen dërguar gjithë OE-ve të interesuar, në pikën 6 të këtyre pyetjeve, përgjigje "në bazë të modernizimit eliminohen, drasat, trarët dhe mbajtësit prej druri. Modernizimi duhet të jetë nga teknologjia më e avancuar". Kjo është përgjigje e dhenë gjithë OE-ve me datë 29.03.2016.

Në kërkesë për rishqyrtim dhënë nga OE ankues në faqe 14 pika 5, vet OE ankues pranon se është bërë gabim gjatë ofertimit se është ofertuar me dru, të cilën gjë e pranoj edhe në seancë.

Andaj me përgjegjësi komisioni vlerësimit ka vlerësuar ofertën e gjithë OE-ve dhe në gjitha pikat për eliminim dërguar OE ankues qëndrojnë.

Sa i përket validiteti, është e vërtetë që ky tender është stërzgjatur. Validiteti nuk është kërkaur para skadimit, mirëpo OE –të janë trajtua në mënyrë të barbartë. OE-të kanë vazhduar validitetin dhe nuk kanë dhënë vërejtje.

Për motor nuk është kërkuar fare fuqia motorave, mirëpo është kërkuar dizajnimi dhe fiorma kullës si do funksionoj.

OE ankues paketat ftohëse që janë kërkuar CHSB 21 nga materiali PVC ekuivalente nuk i ka ofruar fare, ka ofrua drasat me dimensione 40x10x2500mm ku e ka elaboruar në faqe 96 të ofertës. Diznet në specifikim është kërkuar dizne për pëkëratje katërkëndshme nëpër sipërfaqen e enës ftohëse, kurse në ofertën e OE ankues nuk është ofrua kjo paisje.

Filtrat për pastrim në specifikim teknik është kërkur montimi pajisjeve për pengimin e mbylljes së dizneve nga pa pastërtija që gjendet në sistemin gypave të vjetër, kurse OE nuk ka ofruar këtë pajisje.

Pjesën elektrike nuk ka ofruar asnjë sqarim lidhur me pajisjet elektrike, furnizim dhe komandim. Nuk ka prezantuar certifikata ISO për pajisjet e kërkuara, për paketa ftohëse, dizne, kabllo etj. Plani ideor nuk është sipas kërkesës së dosjes për modernizimin e fushave të ftohjes.
Ne faqe 104 me titullin "Instalation of neë Technologie", OE ankues pësëri ka ofruar përdorimin e drurit, ku në dosje të tenderit është kërkuar eliminimi i tyre.

Në fq. 106 OE ankues ka ofruar plan ideor me numër vizatimi N16-139-001, i cili është i ngjashëm me planin ekzistues, ku edhe cekjet më lart se ky është përshkrim i pajisjes, që ka len të kuptoj se as plani ideor nuk e ka ofruar.

OE i rekomanduar për kontrat është prodhues i paketave ftohëse të plastikës ERH20, është prodhues i dizneve. Për gjitha pajisjet tjerra që ka ofruar ka ofruar certifkatën , katalogun dhe lejen e prodhuesit. Ndërsa OE ankues nuk ka ofruar as gypat prurës të ujit që janë kërkuar.

OE i rekomanduar ka ofruar katalogjet e referencave të viteve 2013-2014-2015 dhe ka

bashkangjitur tri referenca nga shfrytëzuesi i fundit që ka pranuar punën".

Në vazhdim fjala iu dha ekspertit shqyrtues z.Fazliu i cili deklaroj: "sa i përket validitetit, kemi vlerësuar se ka pas vonesë, mirëpo e njëjta është pranuar nga OE ankues të vazhdohet validiteti, dhe nuk mundet me vendimin e OSHP të vitit 2014 të anulohet aktivieti me rast mos vazhdimit apo voneses, dhe në rastin konkret ka vonesë mirëpo ka vazhdim të validitetit të ofertave. Poashtu sa i përket ofertës të OE ankues, sëbashku me ekspertinteknik detajisht kemi bërë shqyrtimin e pretendimeve dhe ofertës së OE ankues, dhe e njëjtat është thuajse komplet e papërgjegjshme. Lidhur me marrëveshjen e konzorciumit, është ofruar nga OE ankues, mirëpo i mungon pika 2 e nenit 71 të LPP-së, ku thuhet: "OE duhet deklaruar se marrin pjesë si grup në tërësi këtë aktivitet të prokurimit,dhe jo ndaras apo veq e veq", kjo pikë mungon në marveshjen e konzerciumit të OE ankues.

Pika lidhur me raportin e vlerësimit, OE-ve i është dërguar letra standarde, dhe në shkresat e lëndës janë në detaje arsyet e eliminimit të këtij OE ankues.

Në FDT është kërkuar dy referenca tri vitet e fundit, OE ankues nuk pltëoson këtë pikë me asnjë referencë, njëra nga referencat është e vitit 2012, ndërsa tjetra nuk ka kapacitetin e motorëve sië është kërkuar 150 deri 250KË.

Në vazhdim fjala iu dha ekspertit teknik z.Sarkocevic i cili deklaroj:

Ajo çka është e qartë është se dy OE-të kanë ofruar elektromotor të njëjtës fuqi të tipit të ndryshëm. Motori i ofruar nga OE ankues siguron kapacitetin e qarkullimit të ajrit ashtu siç është kërkuar.

OE i rekomanduar ka ofruar paketën prej PVC sipas kërkesës së AK-së, poashtu në aspektin teknik, pajisjet e ofruara nga OE i rekomanduar për kontrat plëtësojnë kërkesat e AK-së.

Anëtari i panelit z.Mileknovic pyeti ekspertin teknik se referecnat e OE të rekomanduar a plotësojnë kërkesat e AK-së. Në përgjigje z.Sarkocevic deklaroj:

JO , referencat e OE të rekomanduar për kontratë nuk plotësojnë kërkesat e AK-së.

Në fjalen përfundimtare përfaqësuesi i OE ankues deklaroj: "propozojmë që OSHP me autoritetin që ka, të merr vendimin e merituar, pasi nëse ne si OE nuk kemi plotësuar 100%, OE i rekomanduar është shumë më i mangët dhe çmim shumë të lart.I rekomandojmë panelit që të anuloj këtë aktivitet të prokurimit dhe ti jepet mundësi të gjithë OE-ve për pjesëmarrje korrekte.

Në fjalen përfundimtare përfaqësuesi i AK-së deklaroj: "I propozojmë panelit të refuzohet ankesa e OE ankues dhe të vazhdohet më tutje konform ekspertizës së ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, raportit të vlerësimit të komisionit vlerësues të AK-së, shqyrtimit të pikës pretenduese të parashtruesit të ankesës, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues-teknik të cekur në ekspertizë, parashtresës së OE ankues, parashtresës së AK-së, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, konstaton dhe vlerëson se OE ankues nuk ka arritur te dëshmoj interes juridiko-material në këtë aktivitet të prokurimit konform nenit 4.1.26 dhe nenit 111 të LPP-së, për faktin se edhe gjatë seancës dëgjimore u vërtetua fakti se OE ankues ka ofruar ofertë të papërgjegjshme teknikisht, i cili NUK ka arritur të plotësoj as përsë afërmi kërkesat e FDT-së dhe njoftimit për kontrat në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit.

Paneli shqyrtues, gjithashtu konstaton se oferta e OE ankues është e papërgjegjshme sa i përket kërkesës në lidhje me referencat e kërkuar për punë të ngjashme, vlerëson arsyeja e eliminimit, për faktin se OE ankues NUK ka ofruar referenca sipas kërkesës së FDT-së, konkretisht dy referenca të realizuar në 3 vitet e fundit, për faktin se:

- referencat e lëshuara nga SLOVNAFT.A.S CLEN SKUPINY MOL e realizuar me 02.08.2012 e cila nuk përmbush kërkesat e dosjes së tenderit (në dosjen e tenderit është kërkuar të jetë për tri vitet e fundit)

  Ju keni prezantuar referencat të lëshuara nga HEP- Proizvodnja d.o.o Pogon TE-TO Osijek –Kroaci që është realizuar në periudhën 2014 dhe 2015, por referenca nuk plotëson kriterin e dosjes së tenderit për energjinë e kërkuar të MË,
- OE ankues ka ofruar referenc me fuqi të përgjithshme 89/139MË, ndërsa është kërkuar me fuqi 150/250MË.

Paneli shqyrtues konstaton se OE ankues është i papërgjegjshëm sa i përket kërkesës të FDT-së në lidhje me çertifikaten ISO, Nuk ka çertifikat ISO të prodhuesit për produktet që dotë liferoj : electromotor, ventilator, filter të pastrimit, paket ftohëse etj.

Paneli shqyrtues konstatoi se oferta e OE ankues, është e papërgjegjshme sa i përket anes teknike të kërkuar në FDT, në lidhje me at, paketat ftohëse që janë kërkuar CHSB 21 nga materiali PVC ekuivalente nuk i ka ofruar fare, ka ofrua drasat me dimensione 40x10x2500mm ku e ka

elaboruar në faqe 96 të ofertës, ku për të njëjtin specifikim ku është kërkuar në FDT, kanë qenë të njoftuar me dt. 29.03.2016 edhe me shkres të gjithë OE-të pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit nga ana e AK-së, gjatë pyetjeve dhe përgjigjeve s'qaruese.

- Diznet në specifikim është kërkuar dizne për spërkatje katërkëndshme nëpër sipërfaqen e enës ftohëse, kurse në ofertën e OE ankues nuk është ofruar kjo paisje.
- Filtrat për pastrim në specifikim teknik është kërkur montimi pajisjeve për pengimin e mbylljes së dizneve nga pa pastërtija që gjendet në sistemin gypave të vjetër, kurse OE nuk ka ofruar këtë pajisje.

Paneli shqyrtues konstatoi se Autoriteti kontraktues në harmoni me nenin 59.4 të LPP-së ka bërë vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e ofertave, duke rekomanduar për dhënien e kontratës OE i cili në harmoni me kriteret e kërkuara në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontrat ka ofertuar në këtë aktivitetit të prokurimit.

Andaj Paneli shqyrtues, duke u bazuar në nenin 117 të LPP-së, si dhe duke u mbështetur në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike :
Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur
nuk mund të ushtron ankesë,
por për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh,
pas pranimit të këtij vendimi, mund të ngritë
kërkesë-padi në Gjykatën Themelore - Prishtinë
Departamenti për Çështje Administrative.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
Nuhi Paçarizi